Prof. Asoc. Dr. Bejtush GASHI
Dekan i Fakultetit të Sigurisë Publike

Prof. Asoc. Dr. Bejtush Gashi është ligjërues i lëndëve: "Menaxhimi i Krizave", "Menaxhimi Emergjent dhe Terrorizmi", "Siguria e Brendshme dhe Menaxhimi Emergjent", "Operacionet humanitare në fatkeqësitë ndërkombëtare". Profesor Gashi ka mbaruar studimet themelore në Universitetin e Beogradit gjatë viteve 1976/77 – 1982/83, ndërsa ka magjistruar në Universitetin e Zagrebit gjatë viteve 1985/86 – 1988/89. Studimet e doktoratës i ka mbaruar në Akademinë e Mbrojtjes "Spiro Moisiu" gjatë viteve 2002/03 – 2005 në Tiranë.
Prof. Asoc. Dr. Bejtush Gashi, ka përvojë të mësimdhënies brenda dhe jashtë vendit në nivel universitar. Ishte ligjërues në Universitetin e Prishtinës nga viti 1984/85 deri në vitin 2013/14, si dhe i angazhuar në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë dhe në institucione private të arsimit të lartë në Kosovë nga viti 2007/08 deri më 2018/19. Profesor Gashi në cilësinë e profesorit vizitor ka mbajtur leksione nga fusha e sigurisë në disa universitete të njohura të Evropës Juglindore, pastaj në Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe në Akademinë Ushtarake "Spiro Moisiu" në Tiranë.

Prof. Asoc. Dr. Bejtush Gashi deri tash ka marrë pjesë në mbi 50 konferenca shkencore në nivel vendor e ndërkombëtar. Deri tash ka publikuar mbi 30 punime shkencore me recension ndërkombëtar me tituj: "Sfidat e sigurisë përballë një bote në ndryshim: Rasti i Kosovës", "Transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ushtri dhe sfidat e këtij procesi", "Kosova përball rreziqeve hibride", "Roli dhe ndikimi i diplomacisë së shteteve të vogla në mjedisin e sigurisë kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare", pastaj "Konceptet e sigurisë nacionale të Kosovës, **s**fidat përballë një bote në ndryshim", "Sfidat globale të sigurisë dhe ndikimi i tyre në Strategjinë e Sigurisë së Kosovës", "Sfidat e sigurisë së Aviacionit Civil në shekullin XXI", "Konceptet e sigurisë në Kosovën e pavarur", "Impakti i krimit të organizuar në sistemin e sigurisë së shteteve në tranzicion", "Konceptet e reja të sigurisë dhe definimi i politikës së sigurisë në Kosovë" etj.
Prof. Asoc. Dr. Bejtush Gashi është bashkautor i katër librave universitarë si: "Sistemi i menaxhimit të krizave" (2012), "Roli dhe përgjegjësitë e Policisë në sistemin e Sigurisë së Brendshme në Kosovë" (20012), "Konfliktet ndërkombëtare dhe ndëretnike" (2008) dhe "Ushtria jugosllave dhe prania e saj në Kosovë në periudhën 1945 - 1990" (2006).
Gjatë përvojës akademike, profesor Gashi ka mentoruar më shumë se 80 kandidatë për diplomim në studimet themelore, mbi 40 kandidatë master, si dhe ishte anëtar i Komisionit të temave të disertacionit. Ishte recensent i disa librave universitarë si: "Gjeopolitika dhe gjeostrategjia" i autorit prof. asc. dr. Haxhi Ferati, pastaj "Integrimi euro-atlantik i Kosovës", i autorit dr. Astrit Gjunkshi, "Bazat e diplomacisë" i autorit dr. Milan Jazbec dhe "Mbrojtja dhe shpëtimi nga fatkeqësitë elementare natyrore" i autorit mr.sc. Skënder Syla.
Gjatë karrierës profesionale, profesor Gashi ka ushtruar edhe pozitën e Drejtorit të Institutit për Studime të Sigurisë dhe Integrimeve në "Katana" 2007-2010, pastaj ishte anëtar i Bordit të

revistave shkencore “Vizione” Shkup dhe “Trendi Global” në Prishtinë 2008-2016, shef i Katedrës së ligjëruesve të lëndës së Mbrojtjes në kuadër të Universitetit të Prishtinës 1996-2002, Drejtor i Politikave të Sigurisë së Brendshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme 2005-2007, Zëvendësministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës 2011 – 2014, si dhe Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme 13 prill-15 tetor 2018.

Prof. Asoc. Dr. Bejtush Gashi
E-mail: bejtush.gashi@rks-gov.net
Telefon: 028/590-070
Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Fakulteti i Sigurisë Publike
Vushtrri